

VENDIM
Nr. 954, datë 5.9.2012

PËR KRIJIMIN E FONDIT TË EKONOMISË KREATIVE (ARTIZANATI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pikat 3 e 4, 5, 6, 7, 8 e 9 të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit të Ekonomisë Kreative, me vlerë të përgjithshme 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, për një periudhë zbatimi prej 4 (katër) vjetësh, duke filluar nga viti 2013.

2. Për secilin nga vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, vlera e fondit do të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

3. Fondi i Ekonomisë Kreative, përveç fondeve nga Buxheti i Shtetit, të parashikuar si më sipër, mund të ketë si burim financimi edhe donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare.

4. Fondi i Ekonomisë Kreative ka për qëllim dhënien e ndihmës financiare, në formë subvencioni të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e artizanatit, ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë. Në varësi të projektit konkurrues, të përgatitur nga aplikantët, skema mbulon nga 60% deri 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara, brenda kufirit të lartpërmendur. Përfitimi i ndërmarrjeve artizanale nga mbështetja e programeve apo projekteve përmes kreditimit të lehtësuar, duke përdorur fonde nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare, nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga Fondi i Ekonomisë Kreative.

5. Projektet që përzgjidhen nga sektori i artizanatit, mbulojnë 3 nga fushat e mëposhtme:

a) Zhvillimi i produkteve të reja;

b) Marketingu i produktit;

c) Kualifikimi dhe ndërtimi i kapaciteteve menaxheriale të ndërmarrjes aplikuese.

6. Përfitojnë nga Fondi i Ekonomisë Kreative ndërmarrjet mikro dhe të vogla, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) Janë ndërmarrje, të klasifikuara si mikro ose të vogla, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, të ndryshuar;

b) Kanë selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të vendit;

c) Prodhonë në Shqipëri produkte, të cilat aktualisht tregtohen brenda vendit, eksportohen jashtë ose krijojnë vende të reja pune;

ç) Propozojnë një sërë aktivitetesh koherente në kuadër të Fondit të Ekonomisë Kreative (Artizanati), duke ndikuar më së shumti apo në mënyrë integrale, në aktivitetet e aplikuesit dhe proceset e krijimit të vlerave brenda territorit të vendit;

d) Demonstrojnë se aktivitetet që propozohen për mbështetje nga Fondi i Ekonomisë Kreative (Artizanati) janë të rëndësishme për zhvillimin e biznesit të tyre, duke treguar se ato kanë:

i) nevojë për t’u përmirësuar, gjë që do të preket nga aktivitetet e propozuara;

ii) një vlerësim për përfitimet e biznesit nga përmirësimi, në bazë të të cilit do të zhvillohen aktivitetet e propozuara;

iii) një plan biznesi ose një projekt, duke demonstruar sa më sipër, i cili do të integrohet dhe do të materializohet më tej nga aktivitetet e propozuara.

dh) Tregojnë që ato nuk kanë mundësi të vazhdojnë në mënyrë optimale pa asistencë;

e) Janë të afta për zbatimin e duhur dhe në kohë të aktiviteteve të propozuara;

ë) Janë në gjendje të financojnë 100% të të gjitha kostove të projektit të propozuar para përfundimit të tij.

7. Për projektet që mund të përzgjidhen, duhet të identifikohen dhe të përshkruhen detyrimisht:

a) qëllimi i projektit;

- b) kufizimi rajonal;
- c) veprimtaria zejtare/artizanale në rajon;
- ç) me hollësi veprimtaritë që do të kryhen;
- d) termat e referencës për të gjitha aktivitetet që duhen nënkontraktuar;
- dh) buxheti i detajuar, përfshirë burimet financiare dhe/ose të ardhurat;
- e) mënyra e menaxhimit të projektit, sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit;
- ë) rezultatet e pritshme;
- f) indikatorët e verifikueshëm.

8. Për qëllimet e këtij fondi, mund të merren në konsideratë vetëm produktet materiale zejtare/artizanale, me përjashtim të ushqimeve dhe pijeve.

9. Pagesa e subvencionit të bëhet në fund të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

10. Subvencioni nuk mund të jepet më tepër se një herë për të njëjtën ndërmarrje.

11. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për administrimin e Fondit të Ekonomisë Kreative (Artizanati). Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve sipas pikave 6 dhe 8 të këtij vendimi, përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit të Ekonomisë Kreative, e cila miratohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave.

12. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përfshihen në buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

13. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për parashikimin e Fondit të Ekonomisë Kreative në buxhetin afatmesëm.

14. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha